

JANAR-MARS

2021



KLGJ
KËSHILLI I LARTË
GJYQËSOR

PËRMBAJTJA

FAQE 2

KOMPETENCAT DHE VEPRIMTARIA E
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

FAQE 3 - 5

AKTIVITETET E KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR

FAQE 6

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NË
RRJETET SOCIALE

RRETH NESH

Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucion kushtetues, organi qeverisës që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është themeluar në 12 dhjetor 2018 dhe përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë.

Vizioni i KLGJ: Drejtësia në Shqipëri do të arrihet kur të gjithë qytetarët të jenë të sigurt se ata do të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në bazë të ligjit, nga një sistem gjyqësor që është i pavarur, etik dhe efikas.


Misioni i KLGJ është të qeverisë një sistem gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon përsosmëri dhe që meriton besimin e publikut.

Transparenca, ndershmëria, llogaridhënia dhe besueshmëria janë parimet udhëheqëse të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.


Baza ligjore

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 115/2016, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

KOMPETENCAT



Veprimtaria e KLGJ-së (Janar-Mars 2021):



- 28 mbledhje plenare
- 114 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 22 akte kolektive, Janar 2021
 - 12 akte kolektive, Shkurt 2021
 - 20 akte kolektive, Mars 2021
 - 14 akte individuale, Janar 2021
 - 14 akte individuale, Shkurt 2021
 - 22 akte individuale, Mars 2021

Pjesa tjetër përfshihen rregulla të brendshme, aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare dhe hartimin e aktit nënligjor me karakter normative si dhe udhëzime.

20 JANAR 2021

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami, mirëpriti në një takim zyrtar Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sh.S.Znj. Yuri Kim.

Në këtë takim, Znj. Llagami u shoqërua nga Zëvendëskryetari i Gykatës së Lartë Z. Sokol Sadushi, Zëvendëskryetari Z. Maksim Qoku, si dhe Kryetarët e Komisioneve të Përhershme, Z. Medi Bici dhe Z. Ilir Toska. Prezent në këtë event ishin gjithashtu edhe Znj. Mikaela Meredith, Përfaqësuesja e USAID për Shqipërinë si dhe Z. Ben Rockëell, Drejtor për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Në përfundim të takimit, palët shprehën angazhimin maksimal për të forcuar më tej bashkëpunimin bilateral, përmes zbatimit të projekteve strategjike të cilat synojnë ofrimin e një drejtësie të shpejtë dhe pa vonesa për qytetarët.



26 JANAR 2021

Këshilli Lartë Gjyqësor, zhvilloi një takim online me ambasadorin e Delegacionit të Bashkimit Evropian, Sh.T.Z. Luigi Soreca, me fokus veprimtarinë e KLGJ-së në kuadrin e zbatimit të reformës në drejtësi dhe integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në këtë takim, Znj. Llagami u shoqërua nga Zëvendëskryetari i Gykatës së Lartë Z. Sokol Sadushi, Zëvendëskryetari Z. Maksim Qoku, si dhe Kryetarët e Komisioneve të Përhershme, Z. Medi Bici dhe Z. Ilir Toska. Prezent në këtë event ishin gjithashtu edhe Znj. Mikaela Meredith, Përfaqësuesja e USAID për Shqipërinë si dhe Z. Ben Rockëell, Drejtor për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Në përfundim të takimit, Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Sh.T.Z. Luigi Soreca, pasi ju drejtua anëtarëve të Këshillit me një mesazh inkurajues, duke u shprehur se: "Ju nuk jeni vetëm! Ne, së bashku me partnerët e tjerë, jemi të gatshëm të vijojmë dhe të intensivikojmë mbështetjen tonë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, punën dhe veprimtarinë e tij, për zbatimin e reformës në drejtësi me qëllim integritimin evropian të Shqipërisë".



3 SHKURT 2021

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami, mirëpriti në një takim zyrtar Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sh.S.Znj. Yuri Kim.

Në këtë takim, Znj. Llagami u shoqërua nga Zëvendëskryetari i Gykatës së Lartë Z. Sokol Sadushi, Zëvendëskryetari Z. Maksim Qoku, si dhe Kryetarët e Komisioneve të Përhershme, Z. Medi Bici dhe Z. Ilir Toska. Prezent në këtë event ishin gjithashtu edhe Znj. Mikaela Meredith, Përfaqësuesja e USAID për Shqipërinë si dhe Z. Ben Rockëell, Drejtor për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Në përfundim të takimit, palët shprehën angazhimin maksimal për të forcuar më tej bashkëpunimin bilateral, përmes zbatimit të projekteve strategjike të cilat synojnë ofrimin e një drejtësie të shpejtë dhe pa vonesa për qytetarët.



3 SHKURT 2021

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami, priti në një takim pune përfaqësuesit e Institutit për Politika dhe Studime Ligjore (IPLS) në lidhje me zbatimin e Projektit “Të gjithë sytë nga Drejtësia”, i financuar nga Ambasada e Vendeve të Ulëta”.

Në këtë takim u diskutua për rolin kyç të KLGJ-së në hartimin, miratimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e Planit të dytë strategjik të Këshillit për sistemin gjyqësor për vitin 2021-2023, dhe kjo në kuadrin e politikave më të gjera kombëtare në fushën e drejtësisë.

Në këtë kontekst, KLGJ-ja mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar, si me organizatën e IPLS-së dhe me shoqërinë civile në përgjithësi, duke shkëmbyer në mënyrë të ndërsjelltë informacionin e nevojshëm me qëllim monitorimin e ecurisë së reformës në drejtësi dhe integritet të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



18 SHKURT 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor shpreh falënderimet në emër të sistemit gjyqësor për kontributin e Ambasadës së SHBA për pasjisjen e personelit të gjykatave dhe të KLGJ me maska mbrojtëse, doreza dhe dezinfektues për të garantuar sigurinë e personelit dhe të publikut. Tashmë ka filluar shpërndarja e këtyre mjeteve të nevojshme mbrojtëse në gjykatat në Tiranë dhe do të bashkëpunojmë me projektin e USAID ‘Justice for all’ (Drejtësi për të gjithë) për të vijuar shpërndarjen në të gjitha gjykatat e tjera.

Këshilli i Lartë Gjyqësor përfiton nga rasti për të shprehur edhe një herë mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhe të gjithanshme që ka marrë nga partnerët tanë të Ambasadës dhe Qeverisë amerikane.



16 MARS 2021

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami, priti në një takim kortezie Ambasadorin e Austrisë në Shqipëri, SH.T.Z. Christian Steiner.

Znj. Llagami e njohu ambasadorin austriak me zhvillimet dhe sfidat aktuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor, veçanërisht me hapat e ndërmarra në lidhje me plotësimin e vendeve vakante të Gjykatës së Lartë. Znj. Llagami u shpreh se vendimmarrja e KLGJ-së, për t’i propozuar Presidentit të Republikës, për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, katër gjyqtarët e parë nga radhët e sistemit gjyqësor, është një hap madhor për funksionalizimin e plotë të kësaj gjykate.

Në mbyllje të këtij takimi, palët u dakordësuan mbi mundësitë e bashkëpunimit nëpërmjet projekteve të ndryshme në fushën e drejtësisë.





Këshilli i Lartë Gjyqësor, në datën 17.03.2021, në vijim të vendimmarrjes së tij, i ka përcjellë Presidentit të Republikës propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet numër 241, 242, 243 dhe 244, datë 09.07.2020.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, brenda afatit të kandidimit kandiduan gjithsej tetë kandidatë. Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, me qëllim bërjen e Gjykatës së Lartë funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli, konsideroi zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira, duke qenë se për ngritjen në detyrë në gjykatat më të larta kërkohen dy vlerësime etike dhe profesionale të kandidatëve, për të bërë renditjen e tyre dhe përcaktimin e kandidatit të renditur më lart.

Pas përfundimit të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për dyandidate, respektivisht për shkak të tërheqjes nga kandidimi dhe të skualifikimit dhe përjashtimit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë si rrjedhojë e vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për gjashtë kandidatët e tjerë, Këshilli verifikoi plotësimin prej tyre të të gjitha kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre.

Në vijim, Këshilli vendosi fillimin e fazës së dytë të ngritjes në detyrë, procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, duke caktuar edhe relatorin përkatës, pas zhvillimit të shortit. Gjatë kësaj faze, një nga kandidatët u tërhoq nga kandidimi dhe Këshilli vendosi përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për këtë kandidatë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, është realizuar renditja e kandidatëve për secilin pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, sipas së cilës Këshilli vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin e katër kandidatëve.

Në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë është zhvilluar më datë 24.03.2021 ceremonia mirëseardhjes dhe fillimit të detyrës së katër anëtarëve më të rinj të trupës gjyqësore, gjyqtarëve Sokol Binaj, Albana Boksi, Sandër Simoni dhe Klodian Kurushi.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR



Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim krijimin e kushteve të pjesëmarrjes së palëve dhe zhvillimin normal të seancave gjyqësore nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, në përputhje me rregullat e përcaktuara gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë të shkaktuar nga Covid 19, për shkak të mungesës së ambienteve të mjaftueshme në Gjykatën Administrative të Apelit, vendosi transferimin e përkohshëm të seancave gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pranë sallës "Amfiteatri", në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe lehtësimin e ngarkesës për një afat të caktuar për dy prej anëtarëve të Kolegjit.



KLGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

601

-na ndiqni-

TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Mosha	Ndjekësit	Numri i vizitave nga ndjekësit
13-17	1	3
65+	11	59
55-64	27	112
45-54	53	202
35-44	125	547
18-24	128	386
25-34	205	838

Numri i vizitave nga ndjekësit (Total)	Numri i vizitave nga ndjekësit për postimet (Total)	Numri i klimeve nga përdoruesit
<u>2,147</u>	<u>4,545</u>	<u>955</u>

Pelqime ne total	Shperndarje e postimeve ne total
<u>310</u>	<u>9</u>